
16 SHTIMI I PËRMBAJTJES DIGJITALE

Të dhënat për materialin mund t'i plotësoni me përmbajtje digjitale (p.sh. me fotografi, audio, video etj.).

Kushti

Regjistrimi duhet të jetë në COBIB.

Procedura

1. Në klasën **Regjistrimi bibliografik** gjeni dhe përzgjidhni regjistrimin.
2. Përzgjidhni metodën **Objekti / Shto përmbajtjen digjitale në dCOBISS**.

Në një dritare të ndarë hapet aplikacioni dCOBISS (Repozitori digjital COBISS), ku ndodhen të dhënat për publikimin e regjistrimit të përzgjedhur.

3. Nëse regjistrimi në dCOBISS ende nuk ekziston, plotësoni të dhënat për publikimin e tij (të dhënat nuk janë të detyrueshme) dhe ruane atë.
4. Klikoni butonin **Shto skedarin kryesor**. Nëse skedari kryesor është i përcaktuar, klikoni butonin **Shto skedarin shtesë**.

Hapet dritarja **Shtimi i skedarit kryesor** ose dritarja **Shtimi i skedarit shtesë**.

5. Vendosni përshkrimin e skedarit.
6. Klikoni butonin **Ngarko skedarin kryesor** ose butonin **Ngarko skedarin shtesë**.

Hapet dritarja për qasje në skedarët, të cilët ndodhen në kompjuterin tuaj.

5. Gjeni skedarin që dëshironi ta shtoni në regjistrim dhe klikoni butonin **Hap (Open)**.

Skedari i përzgjedhur ngarkohet.

6. Gjatë publikimit skedarin kryesor dhe atë shtesë mund t'i shkëmbeni, t'i largoni apo përshkrimet e tyre t'i ndryshoni.

Mundësitë...

Përmbajtjen digjitale mund ta shtoni edhe tek regjistrimi, i cili ndodhet vetëm në bazën e përbashkët të të dhënave.